



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1643/1 Prot.

Vlorë më, 26. 11. 2019

**VENDIM**

**Nr. 50, datë 26. 11. 2019**

**PËR**

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT "BACHELOR" NË "DREJTËSI"  
NË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË  
"MASTER I SHKENCAVE" NË "DREJTËSI", NË UNIVERSITETIN "ISMAIL  
QEMALI", VLORË**

Mbështetur në nenin 49, pika 1, shkronja dh, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Udhëzimi nr. 31, datë 29. 12. 2017 "Për përcaktimin e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë", në vendimin 61, datë 13.11. 2019 si dhe shkresën e Administratores nr. 1604/1 prot, datë 20. 11. 2019 Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 26. 11. 2019

**VENDOS**

1. Të miratojë riorganizimin e programit të ciklit të parë të studimeve "Bachelor" në "Drejtësi", në program të integruar të ciklit të dytë studimeve "Master i shkencave" në "Drejtësi", në përshtatje me ndryshimet ligjore që parashikojnë riorganizimin e këtij programi studimi, nga program i ciklit të parë të studimeve me 180 kredite, në program të integruar studimi të ciklit të dytë me 300 kredite.
2. Një kopje e këtij vendimi së bashku me të gjithë dokumentacionin përkatës, i përcillet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
3. Ky program studimi parashikohet të zbatohet për vitin akademik 2020- 2021 pas urdhërit të miratimit nga MASR
4. Bashkëlidhur këtij vendimi vendoset një kopje e shkresës nr. nr. 1604/1 prot, datë 20. 11. 2019
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Dr. Ervis Moxha - Kryetar

Anjeza Shiko – Anëtar

Dr. Marinela Muço– Anëtar

Dr. Enida Pulaj – Anëtar

Rajmonda Simoimeri – Anëtar

Dr. Elsajed Rexhaj – Anëtar